

Mbrojtjet Ligjore për Parandalimin e Torturës E Drejta e Aksesit tek Avokatët për Personat që u është hequr Liria

Mars 2010

Hyrje

Tortura dhe trajtimi apo ndëshkimi mizor, jo human dhe degradues (“keqtrajtimi”), pothuajse në të gjitha rastet, ndodh në mënyrë të fshehtë. Aksesit tek avokatët dhe mjekët dhe kontakti me shoqërinë dhe anëtarët e familjes krijon një ambient më të hapur në burgje i cili ndihmon në parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit të tjera. Burgjet jo komunikuese dhe sekrete krijojnë një atmosferë jondëshkuese për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe mund të përbëjnë torturë ose keqtrajtim në vetvete. E drejta për tu mbrojtur nga tortura dhe keqtrajtimet e tjera është një e drejtë themelore nga e cila nuk lejohet asnjë devijim.¹

Kjo përmbledhje e shkurtër ka si qëllim të nxjerrë në pah statusin aktual të ligjit në lidhje me aksesin tek avokati² ligjor menjëherë pas heqjes së lirisë, si një mbrojtje ndaj torturës dhe keqtrajtitimit.

Funksioni I të drejtës së aksesit tek avokatët për të arrestuarin³ është jo vetëm për të përgatitur mbrojtjen në rastet kriminale por gjithashtu për të siguruar një prezencë të pavarur gjatë arrestit dhe marrjes në pyetje (e shoqëruar apo jo me procedim penal). Prezenca e një avokati mund të ndihmojë për të siguruar që të drejtat e personit të arrestuar të respektohen dhe që autoritetet të mos tejkalojnë kompetencat e tyre ligjore. Në rastet kur

¹ Shiko Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, nenet 4 dhe 7, si dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit Mizor, Jo Human ose Degradues, nenet 2 dhe 16.

² Për qëllimet e këtij materiali, nuk është bërë asnjë dallim midis këshilltarëve ligjor, avokatëve dhe përfaqësuesve ligjor. asnjë ndryshim.

ka nisur një procedim penal, avokati mund të vlerësojë gjithashtu nëse procedura e policisë është në përputhje me kërkesat për një gjykim të drejtë (dhe në qoftë se është e nevojshme mund të ndërhyjë).

Neni 2 dhe 16 I Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimet e Ndëshkimit Mizor, Jo Human dhe Degradues (UNCAT) I kërkon Shteteve Anëtare të ndërrmarin masa efektive për të parandaluar torturën dhe trajtimet e ndëshkimit e tjera mizore, jo humane dhe degraduese. Eksperienca e themelimit të mirë të organeve monitoruese parandaluese si për shëmbull Komiteti European për Parandalimin e Torturës (CPT) tregon se nxjerrja e ligjeve për mbrojtjen e të drejtave si ajo e aksesit tek një avokat, është një nga mënyrat më të mira për Shtetet që të përmbushin detyrimin e tyre për të marrë masa efektive. Organet e parashikuara në Traktatin e Kombeve të Bashkuara si Komiteti I të Drejtave të Njeriut (HRC) dhe Komiteti kundër Torturës (CAT) kanë njohur vecanërisht këtë mbrojtje si thelbësore për parandalimin e torturës dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut.⁴

Shkurtimisht, një shtet ka detyrimin të vendosë masa mbrojtëse për personat të cilëve u është hequr liria- të tillë si aksesit tek avokatët sikurse përshkruhet në këtë material- në qoftë se do të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 2 dhe 16 të UNCAT.

Ky material është i ndare në seksione që ekzaminojnë aspekte ndryshme të të drejtës për të patur akses tek avokatët. Së pari trajtohet mënyra sesi kjo mbrojtje vepron praktikisht tek ata të cilëve u është hequr liria, Së dyti trajtohet se çfarë kuptohet me “akses” – a është e mjaftueshme thjeshtë prezenca e një avokati në rajonin e policisë? Së treti, trajtohet elementi kohë – pse duhet që aksesit të sigurohet sa më shpejtë të jetë e mundur? Së katërti, trajtohet nëse mund të zbatohen në mënyrë legjitime kufizimeve të kësaj të drejte si për shembull në rastet kur mund të çenohet siguria? Së pesti dhe si përfundim, trajtohet se cilat shtete kanë parashikuar tashmë në lëgjislatcionet e tyre të drejtën e aksesit tek avokatët.

I. Si siguron mbrojtje të të drejtave të njeriut aksesit tek avokatët?

Prezenca e avokatit shërben për qëllime të shumëllojshme, përfshirë të mëposhtmet:

- Rivendos balancat ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe të arrestuarit (vecanërisht për sa I përket njohurive mbi ligjin),
- frenon torturën dhe keqtrajtimin,
- denoncon arrestimet arbitrare dhe të papërshtatshme, dhe
- mund të sigurojë një mënyrë alternative për regjistrimin e intervistave në mënyrë që të sigurojë integritetin e çdo prove të mbledhur.

Duke folur nga eksperienca, Reporterit Special i Kombeve të Bashkuara mbi Torturën dhe Trajtimin e Ndëshkimit Mizor, Jo Human dhe Degradues, ka bërë rekomandimet e mëposhtme, në raportin e tij të datës 17 Dhjetor 2002, drejtuar Komitetit mbi të Drejtat e Njeriut:

⁴ Shiko Komentin e Përgjithshme 20, të Komitetit për të Drejtat e Njeriut, të datës 10 Mars 1992, tek § 11 dhe Komentin e Përgjithshëm 2 të Komitetit Kunër Torturës, të datës 24 Janar 2008, tek § 13. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, e cila nuk ka hyrë në fuqi akoma në kohën kur bëhet ky material, e parashikon këtë masë mbrojtëse në nenin 17(2)(d). Shiko: <http://www2.ohchr.org/english/law/disappearance-convention.htm>

Tortura praktikohet më shpesh gjatë arrestit sekret. Arresti sekret duhet të jetë i paligjshëm dhe personat e arrestuara në mënyrë sekrete duhet të lirohen pa vonesë. Cdo informacion duhet të regjistrohet në mënyrë të përpiktë. Bazuar në Parimet Bazë mbi Rolin e Avokatit, të gjithë personat e arrestuar duhet të informohen mbi të drejtën e tyre për tu asistuar nga një avokat i zgjedhur prej tyre ose i caktuar nga Shteti, i cili ti sigurojë asistencë efektive ligjore. Personeli i Sigurisë që nuk respekton këto kushte duhet të nënshtrohen masave disiplinore.⁵

Komiteti i Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës (CAT) ka bërë disa Vërejtje Konkluduese, përfshirë këtu për shëmbull ato mbi Raportin e Katërt Periodik të Kinës, në të cilin Komiteti ka vërejtur me shqetësim “mungesën e mbrojtjeve ligjore për të arrestuarit, përfshirë ... aksesin e kufizuar tek avokatët”.⁶ Në mënyrë të ngjashme, në vërejtjet e tij konkluduese mbi raportin fillestar të Indonezisë, të vitit 2001, CAT citoi si shqetësuese “mungesën e garancive të përshtatshme për të drejtat e personave që u është hequr liria, përfshirë këtu të drejtën për të njoftuar një të afërm ose një palë të tretë si dhe për të patur asistencë mjekësore dhe akses tek avokatët sipas zgjedhjes së tyre...”.⁷ Gjithashtu CAT ka kritikuar (ndër të tjera) Hollandën,⁸ Spanjën,⁹ Azerbaxhanin,¹⁰ Gjeorgjinë,¹¹ Estoninë,¹² Latvinë,¹³ Moldovinë,¹⁴ Republikën Ceke,¹⁵ Sllovakinë,¹⁶ Turqinë¹⁷ dhe Libinë¹⁸ pasi kanë dështuar në sigurimin e kësaj të drejte të gjithë personave që u është hequr liria. Shëmbuj të praktikës së mirë gjenden në seksionin V më poshtë.

Nënkomiteti i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin e Ndëshkimit Mizor, Jo Human dhe Degradues ka dhënë shpjegime të mëtejshme mbi benefitet e të drejtës së aksesit tek avokatët:

Nga një pikëpamje parandaluese, aksesin tek avokati është një mbrojtje kundër keqtrajtit dhe si i tillë është një koncept më i gjërë sesa siguri i asistencës ligjore vetëm për ndjekjen e mbrojtjes së dikujt. Prezenca e një avokati gjatë marrjes në pyetje nga policia mund jo vetëm të frenojë keqtrajtimin apo abuzime të tjera nga policia por gjithashtu mund të shërbejë si një mbrojtje për oficerët e policisë në rastet kur ata hasen me pretendime të pabazuara për keqtrajtim. Për më tepër, avokati është personi kyç për të asistuar individin të cilit i është hequr liria gjatë ushtrimit të të drejtave të tij, përfshirë këtu të drejtën e aksesit tek mekanizmat ankimues.¹⁹

⁵ E/CN.4/2003/68, tek § 26(g), e disponueshme tek: http://ap.ohchr.org/documents/alldocs.aspx?doc_id=3360. Në pjesën e mbetur të këtij paragrafi, Reporterit Special vijon të diskutojë masa të tjera mbrojtëse (ku përfshihen ekzaminimet mjekësore dhe paraqitja me menjëhershme përpara një autoritetit gjyqësor).

⁶ Shiko Vërejtjet Konkluduese mbi Kinënë, të viti 12 Dhjetor 2008, CAT/C/CHN/CO/4, tek § 11.

⁷ CAT A/57/44 (2002) tek § 44(e)

⁸ CAT C/NET/CO/4 (2007) tek § 6

⁹ CAT A/58/44 (2003) tek § 62

¹⁰ CAT A/58/44 (2003) tek § 88(g)

¹¹ CAT A/56/44 (2001) tek § 81(e)

¹² CAT A/58/44 (2003) tek § 49(d)

¹³ CAT C/CR/31/3 (2003) tek § 6(h) – Në rastin e Latvia-s Komitetit vërejtë se, edhe kur legjislacioni parashikonte të drejtën e aksesit tek avokati, kjo e drejtë nuk garantohej në praktikë.

¹⁴ CAT A/58/44 (2003) tek § 138(b)

¹⁵ CAT C/CR/32/2 (2004) tek §§ 5(b) dhe 6(d)

¹⁶ CAT A/56/44 (2001) tek § 104(g)

¹⁷ CAT A/46/46 (1991) tek § 121(c)

¹⁸ A/54/44 e (1999) tek § 4(a)

¹⁹ Raport mbi Vizitën e Nënkomitetit mbi Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Mizor, jo Human ose Degradues, në Maldive, (CAT/OP/MDV/1, 26 Shkurt 2009), tek § 62.

Neni 14(3)(b) i Marrëveshjes Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) e cila trajton të drejtat për një proces gjyqësor të drejtë, parashikon se kur bëhet fjalë për procedimet penale e drejta për të komunikuar me një avokat të zgjedhur vet duhet të jetë një garanci minimale.

Në një linjë autoriteti të zhvilluar gjatë dy dekadave të fundit,²⁰ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (ECtHR) ka shpjeguar se prezenca e avokatit gjatë marrjes në pyetje është e pazëvendësueshme për sa i përket nocionit të gjykimit të drejtë. Dëshmia e dhënë në mungesë të avokatit është në mënyrë të paevitueshme një bazë aspak e kënaqshme për krijimin e një bindjeje. Prezenca (ose mungesa) e avokatit mund të përbëjë një faktorë deçiziv në fazat e tjera të një procesi penal. Në çështjen *Lebedev v Russia*,²¹ Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 5(3) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila parashikon se: që masa e arrestit ndaj dikujt të jetë I ligjshëm ajo duhet të caktohet nga një gjykatës. Edhe pse në nenin 5 nuk përmendet shprehimisht, e drejta për asistencë ligjore, shkelja bazohej në faktin se përjashtimi i avokatit të Zotit Lebedev's nga seance dëgjimore fillestare ku do të caktohej masa e arrestit, ishte e padrejtë për kushtet e çështjes.²² Në çështjen e *Salduz v Turkey*,²³ të vitit 2008, gjykata konstatoi se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 nuk mund të konsiderohet se është ushtruar dhe efektive (në kundërshtim me teorinë praktike dhe iluzioniste)²⁴ pa pjesëmarrjen e një avokati që në fazën e parë të marrjes në pyetje.

Organet rajonale kanë arritur në konkluzione të ngjashme. Për shembull, Komisioni Inter-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut ka thënë, në një raport mbi situatën e minoriteteve në Nikaragua, në vitin 1983, se prezenca e një avokati është një mbrojtje e rëndësishme kundër torturës dhe detyrimit për të akuzuar vetveten.²⁵ Në konkluzionet mbi El Salvador në vitin 1986, Komisioni ka thënë se e drejta për avokat zbatohet që nga momenti I parë që personi merret në pyetje.²⁶

Për më tepër, aksesit tek një avokat është një mbrojtje shumë e rëndësishme kundër arrestit të paligjshëm dhe arbitrar, I cili ndalohet nga neni 9 I ICCPR-së. Heqja e lirisë bie në kundërshtim me nenin 9 kurdoherë që autoritet arrestuese nuk veprojnë në përputhje me ligjin dhe procedurat vëndase, ose kur arresti është thjeshtë i paarsyeshëm, kapricoz ose jo proporcional me shkeljen e pretenduar.²⁷ Arresti, I cili deri në të kundërt do të ishte I ligjshëm, mund të bëhet arbitrar në qoftë se, duke marrë në konsideratë situatën, ai nuk mund të jetë më I justifikueshëm.²⁸ Shanset që arresti të jetë arbitrar janë më të mëdhaja kur I arrestuari nuk ka një avokat që të

²⁰ Shiko për shembull *Murray v UK* (Zbatim i 41/1994) dhe *Öcalan v Turkey* (Zbatim i 46221/99). Kjo linjë është ndjekur në disa çështje, në vitin 2009 – Shiko për më shumë seksionin 4, më poshtë.

²¹ Zbatim i 4493/04

²² Si më sipër – shiko në vecanti vendimin e Dhomës, të datës 25 Tetor 2007, tek §§ 84-91.

²³ Zbatim i 36391/02 i vitit 8 Gusht 2002 – shiko në vecanti § 55 e vendimit të Dhomës së Madhe, të datës 27 Nënëtor 2008. *Salduz* është ndjekur në *Adalmış & Kiliç v Turkey* (Zbatim i 25301/04, Vendim i Dhomës i datës 1 Dhjetor 2009).

²⁴ Ky formulim rrjedh nga një vendim më i hershëm: *Imbrioscia v Switzerland* (Zbatim i 13972/88, vendim i datës 24 Nënëtor 1993, shiko § 38).

²⁵ Nga Raporti mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut të një Pjese të Popullsisë së Nikaraguas me Origjinë Miskito, OEA Ser.L/V/11.62, doc.10, rev. 3, 1983, at 100, sic citohet në Foley, *Të luftosh Torturën: Një manual për Gjyqtarë dhe Prokurorë*, e disponueshme tek:

http://www.essex.ac.uk/combatingtorturehandbook/manual/2_content.htm, at § 2.30.

²⁶ Raporti Vjetor i Komisionit Inter-Amerikanë, 1985-1986, OEA/Ser.L/V/II.68, doc. 8 rev. 1, 1986, p.154, El Salvador, sic citohet në Foley (më sipër), tek § 2.30.

²⁷ Shiko Nowak, *Komentari I CCPR*, Engel 2005 (2nd Ed), tek pp.223-5.

²⁸ Si më sipër, tek p 226

vlerësojë ligjshmërinë dhe/ose arsyen e arrestit. Në këtë kontekst dhe duke marrë parasysh të drejtat e tjera të lidhura civile dhe politike, Komiteti I të Drejtave të Njeriut ka komentuar nevojshmërinë e aksesit tek avokatët, në Vërejtjet Konkluduese të bëra mbi disa shtete si Kuëait,²⁹ the Syrian Arab Republic,³⁰ Vietnam,³¹ Morocco³² and Belgium.³³

Shkurtimisht, aksesit tek një avokat ndihmon të sigurohet që mbrojtja e ligjit (kombëtar dhe ndërkombëtar) të shtrihet tek ata që janë në mëshirë të Shtetit.

II. Kur hyn në lojë kjo e drejtë?

Që nga momenti i heqjes së lirisë, autonomia e një personi kufizohet dhe bëhet objekt i vullnetit të autoritetit arrestues. Cekuilibri i pushteteve që rezulton në këtë rast krijon rrezikun që të drejtat e personit të arrestuar të mos respektohen.³⁴ Kjo ndodh vecanërisht kur personi i arrestuar dyshohet të ketë kryer një krim dhe autoritetet arrestuese besojnë se janë në një pozitë superiore morale. Megjithatë, sipas ligjit ndërkombëtar, çdo person ka të drejtën të jetë i mbrojtur nga tortura dhe keqtrajtimi.³⁵

Aksesit tek një avokat nuk është më pak i rëndësishëm kur një personi i kërkohet vetëm ti shoqërojë autoritetet, edhe nëse ai nuk është nën arrest dhe ka opsionin të refuzojë. Në kushte të tilla, ekziston rreziku që ai të keqtrajtohet dhe/ose të detyrohet të akuzojë vetveten ose të tjerët.

Duke qenë se asnjëherë nuk mund të garantohet se autoritetet ndaluese (për shëmbull policia, oficerët e shërbimeve inteligjente dhe rojet e sigurimit të kontraktuara nga Shtetet) do të respektojnë të drejtat në të gjitha rastet, është e nevojshme të sigurohet mbrojtje e përshtatshme- si përsëmbull aksesit tek një avokat ligjor.

Me pak fjalë, zbatimi efektiv i të drejtës për të patur aksesit tek një avokat nënkupton të lejosh një të arrestuar të takojë një përfaqësues ligjor të zgjedhur prej tij sa më shpejtë të jetë e mundur pas heqjes së lirisë. HRC, në Komentin e saj të Përgjithshëm N°32, deklaron se e drejta për të komunikuar me një avokat sipas nenit 14 të ICCPR “kërkon që të akuzuarit ti sigurohet aksesit i menjëherëshëm tek një avokat”.³⁶ Organet rajonale gjithashtu janë të një mendjeje për sa i përket nevojës për aksesit të menjëherëshëm. Për shëmbull, ECTHR ka theksuar në çështjen *Salduz v Turkey*³⁷ se një gjyq mund të bëhet i padrejtë që nga momenti i marrjes së parë në pyetje, në rast se masat mbrojtëse si ajo e aksesit tek një avokat nuk respektohen.

Komiteti Europian mbi Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin e Ndëshkimit Mizor, Jo Human dhe Degradues (CPT) shpalli në vitin 1992 standartin e mëposhtëm:

²⁹ CCPR A/55/40 (2000) tek § 472

³⁰ CCPR A/56/40 (2001) tek § 81(14)

³¹ CCPR A/57/40 vol. I (2002) at § 82(13)

³² CCPR A/55/40 (2000) tek § 108

³³ CCPR A/54/40 (1999) tek § 83. Kjo listë nuk është shteruese; ajo thjeshtë tregon përhapjen e problemit, edhe në vendet që kanë (ose pritet të kenë) të drejtën e aksesit tek avokati të parashikuar në legjislacion ose direktivat procedurale.

³⁴ Shiko Raportin e Reporterit Special të Kombeve të Bashkuara mbi Torturën dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Mizor, Jo Human ose Degradues drejtuar Komisionit të të Drejtave të Njeriut, datë 23 Dhjetorit 2005 (E/CN.4/2006/6, e disponueshme tek: <http://www.un.org/Docs/journal/asp/ws.asp?m=E/CN.4/2006/6>).

³⁵ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Mizor, Jo Human ose Degradues, neni 2.

³⁶ Shiko: <http://daccess-ods.un.org/access.nsf/Get?Open&DS=CCPR/C/GC/32&Lang=E> tek § 34

³⁷ Shiko më sipër, N°23

CPT I kushton rëndësi të vecantë tre të drejtave për personat e arrestuar nga policia: të drejtën e personit të arrestuar për të njoftuar një person të tretë sipas zgjedhjes së tij (anëtar familje, shokë, avokat) se e kanë arrestuar, të drejtën e aksesit tek një avokat, dhe të drejtën për të kërkuar një ekzaminim mjekësor... Sipas opinionit të CPT-së, këto të drejta janë tre mbrojtje thelbësore kundër keqtrajtimit të të arrestuarve dhe *duhet të zbatohen që nga momenti i parë i heqjes së lirisë, pavarësisht se si mund të quhet sipas sistemit ligjor përkatës (kapje, arrest, etj)*³⁸

Në vitin 1996, CPT zhvilloi më tej pikëpamjet e tij mbi këtë temë:

CPT dëshiron të theksojë se periudha menjëherë pas heqjes së lirisë përmban rrezikun më të madhë për kërcënime dhe keqtrajtime fizike. Për rrjedhojë, mundësia e aksesit tek një avokat është një mbrojtje themelore kundër keqtrajtimit të personit që është nën mbikqyrjen e policisë. Ekzistenca e kësaj mundësie ka një efekt frenues ndaj atyre që kanë ndërmend të keqtrajtojnë personat e arrestuar; për më tepër, në rast se ka ndodhur ndonjë keqtrajtim, avokati di të ndërmarri veprimet e duhura.³⁹

Si përfundim, në vitin 2002, CPT rinovoi statusin e kësaj mase mbrojtëse në Europë:

... e drejta e aksesit tek një avokat gjatë arrestit policor është tashmë e njohur gjërësisht në vendet që vizitohen nga CPT; në ato pak vende ku e drejta nuk ekziston akoma, po planifikohet përhapja e kësaj të drejte.⁴⁰

Në vërejtjet e tij mbi raportin e tretë periodic të Federatës Ruse, CAT qortoi “mungesën e aksesit të përshtatshëm tek avokati, mjeku dhe anëtarët e familjes për personat që u është hequr liria, menjëherë pasi ata janë ndaluar...”⁴¹ Në Vërejtjet e tij Konkluduese të vitit 12 Dhjetor 2008, mbi Kazakistanin, Komiteti rekomandoi specifikisht:

Shteti anëtar duhet të marri menjëherë masa efektive për të siguruar që një person të mos jetë subjekt i arrestit të panjoftuar dhe që të gjithë të dyshuarve të arrestuar ti sigurohen në praktikë, të gjitha masat ligjore themelore mbrojtëse, vecanërisht, që nga momenti i heqjes së lirisë ata duhet të gëzojnë të drejtën për të patur akses tek një avokat... për tu informuar mbi të drejtat e tyre dhe akuzat e ngritura kundër tyre si dhe të paraqiten sa më shpejtë para një gjykatësi.⁴²

Direktiva 20 e Direktivës së Ishullit Robben për ndalimin dhe parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit në Afrikë, të miratuar në vitin 2002 nga Komisioni Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut, parashikon specifikisht të drejtën e aksesit tek një avokat “që nga momenti i parë i heqjes së lirisë”⁴³.

Në mars të 2008 Komisioni Inter-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut miratoi një grup direktivash të njohura me emrin Parimet dhe Praktikrat më të Mira mbi Mbrojtjen e

³⁸ Dokumenti I Standarteve të CPT – ekstrakte të seksioneve “thelbësore” të raporteve të CPT, të disponueshme tek: <http://www.cpt.coe.int/en/documents/eng-standards.pdf> [Rev 2009] - ekstrakt nga faqja 6.

³⁹ Si më sipër, tek faqja 8

⁴⁰ Si më sipër, tek faqja 10

⁴¹ Shiko Vërejtjet Konkluduese mbi Rusinë, të datës 6 Qershor 2002, CAT/C/CR/28/4, tek § 6(c)

⁴² CAT C/KAZ/CO/2 (2008) tek § 9

⁴³ Direktivat i janë aneksuar Rezolutës së Komisionit Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut mbi Direktivat dhe Masat për Ndalimin dhe Parandalimin e Torturës, Trajtimin apo Ndëshkimit Mizor, Jo human ose Degradues në Afrikë, I datës 23 Tetor 2002 – shiko: http://www.achpr.org/english/resolutions/resolution66_en.html

Personave Që U Është Hequr Liria në Amerikë. Paragrafi i mëposhtëm është marrë nga Parimi V mbi Procesin Ligjor të Drejtë:

Të gjithë personat që u është hequr liria duhet të kenë të drejtën për tu mbrojtur dhe për të patur avokat ligjore të caktuar prej tyre ose prej familjarëve të tyre ose të siguruar nga Shteti; Ata duhet të kenë të drejtën për të komunikuar privatisht me avokatin e tyre pa ndërhyrje, pa vonesa dhe kufizime të pajustificuara kohore, që nga momenti i arrestit dhe detyrimisht përpara se ata të bëjnë deklaratën e tyre të parë përpara autoritetit kompetent.⁴⁴

Parimi 7 i Parimeve Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Avokatëve⁴⁵ propozon një limit kohor specific:

Qeveritë duhet të sigurojnë që të gjithë personat e arrestuar apo të ndaluar, me apo pa akuzë kriminale, të kenë akses të menjëhershëm tek një avokat, dhe në cdo rast brenda 48 orëve nga momenti i arrestit apo ndalimit.

Kjo kërkesë është përforcuar nga Parimi 15 I Grupit të Parimeve mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën Arrest apo Burgim, aneksuar Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 43/173 datë 9 Dhjetor 1988:

Pavarësisht përjashtimeve të parashikuara në parimin 16, paragrafi 4 dhe në parimin 18, paragrafi 3, komunikimi i personave të arrestuar ose të burgosur me botën e jashtme, vecanërisht me familjen dhe avokatin, nuk duhet të mohohet për më shumë se disa ditë.⁴⁶

Që nga viti 1990, kur këto Rregulla u shpallën, koncepti i ekspertëve për sa i përket elementit kohë është zhvilluar. Zakonisht, tani 48 orë konsiderohen si kohë e gjatë. Për shembull, Reporterit Special i Kombeve të Bashkuara mbi Torturën, në raportin e tij për Komisionin e të Drejtave të Njeriut, datë 27 Shkurt 2003, rekomandonte një limit prej 24 orësh.⁴⁷

Në seksionin V më poshtë, do të mund të gjeni shëmbuj specific të ligjeve kombëtare të cilat parashikojnë të drejtën për të patur akses tek një avokat që nga momenti i heqjes së lirisë. Në vendet ku ka formulime jo të qarta (si në Kanada), Gjykatat kombëtare kanë deklaruar se termi “pa vonesë” do të thotë që nga momenti kur personi është ndaluar – madje dhe në rastet kur ndalesa është bërë pa akuzë.

III. Cfarë kuptimi ka termi “akses” në praktikë?

Është e nevojshme për të ndaluarit të lejohen të takojnë avokatin e tyre përpara se të merren në pyetje nga autoritetet. Takimi duhet të jetë privat në mënyrë që të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit midis avokatit dhe klientit, gjë që është thelbësore për shumë sisteme ligjore – kryesisht në çështjet penale.

HRC deklaron, në Komentin e saj të Përgjithëshëm N°32 mbi të drejtën për barazi përpara gjykatave dhe gjykim të drejtë, se:

⁴⁴ Teksti I Parimeve është i disponueshëm në faqen e internetit të Komisionit:

<http://www.cidh.org/Basicos/English/Basic21.a.Principles and Best Practices PDL.htm>.

⁴⁵ Shiko: <http://www2.ohchr.org/english/law/lawyers.htm>

⁴⁶ Shiko: <http://www.un.org/documents/ga/res/43/a43r173.htm>. Përjashtimet e përmendura në lidhje me “nevojat e hetimit” dhe ruajtjen e “sigurisë dhe rendit”.

⁴⁷ E/CN.4/2003/68, tek § 26(g), e disponueshme tek: http://ap.ohchr.org/documents/alldocs.aspx?doc_id=3360

E drejta për të komunikuar me një avokat kërkon që të akuzuarit ti sigurohet akses i menjëhershëm tek avokati. Avokati duhet të jetë në gjendje të takojë klientin e tij privatisht dhe të komunikojë me të akuzuarin në kushte të tilla që të respektohet plotësisht konfidencialiteti i bisedës së tyre. Për më tepër, avokatët duhet të jenë në gjendje të këshillojnë dhe të përfaqësojnë personat e akuzuar penalisht në përputhje me etikën profesionale të njohur përgjithësisht dhe pa kufizime, influencime, presione ose ndërhyrje nga cdo drejtim.⁴⁸

Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi rolin e Avokatëve parashikojnë masa mbrojtëse të vecanta për çështjet penale, ndër të cilat parimi 5 dhe 8 japin më shumë detaje mbi kërkesat në lidhje me dhënien e aksesit:

Qeveritë duhet të sigurojnë që të gjithë personat që ndalohen apo arrestohen apo akuzohen për një krim, të informohen menjëherë nga autoritetet kompetente mbi të drejtën e tyre për tu asistuar nga një avokat i zgjedhur prej tyre.

Të gjithë personave të arrestuar, të ndaluar apo të burgosur duhet ti sigurohen mundësi, kohë dhe ambiente të përshtatshme, për tu takuar, biseduar dhe konsultuar me një avokat, pa vonesë, ndërprerje, apo censurë dhe duke ruajtur konfidencialitetin. Këto konsultime mund të kryen nën mbikëqyrjen vizive të nënpunësve zbatues të ligjit por ato nuk mund të dëgjohen.

Avokati duhet gjithashtu të jetë present gjatë marrjes në pyetje, vecanërisht për të penguar deklaratimet e pavullnetshme. Reporterit Special i Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqtarëve dhe Avokatëve, deklaroi në raportin e vitit 1998, pas vizitës në ambientet e IRA në Irlandën Veriore, se:

Sipas pikëpamjes së Reporterit Special, është e dëshirueshme prezenca e një avokati gjatë marrjes në pyetje nga policia si një masë mbrojtëse për të drejtat e të akuzuarit. Mungesa e avokatit krijon kushtet për abuzim potencial, vecanërisht në situatat emergjente ku janë të përfshira disa akte serioze kriminale.⁴⁹

Ligji Penal Ndërkombëtar njih nevojën që marrja në pyetje të vëzhgohet në mënyrë të pavarur. Për shembull, neni 55(2)(d) i Statutit të Romës të Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare parashikon se një person i dyshuar për një krim brenda juridiksionit të Gjykatës duhet të ketë të drejtën të merret në pyetje në prezencë të avokatit (me përjashtim të rastit kur personi ka hequr dorë vullnetarisht nga kjo e drejtë).⁵⁰ Garanci të ngjashme gjenden edhe në Statutin e Gjykatave Ndërkombëtare Kriminale të Ruandës⁵¹ dhe ish Jugosllavisë.⁵² Për diskutime të mëtejshme mbi të drejtën për akses tek avokatët dhe për gjykim të drejtë, jeni të lutur ti referoheni seksionit VI më poshtë.

Nuk është e mjaftueshme vetëm që autoritetet të lejojnë avokatët të hynë në vëndet e arrestit. Në qoftë se i arrestuari nuk njih një avokat ose nuk mund ta përballojë një

⁴⁸ See: <http://daccess-ods.un.org/access.nsf/Get?Open&DS=CCPR/C/GC/32&Lang=E> tek § 34.

⁴⁹ E/CN.4/1998/39/Add.4, tek § 47, e disponueshme tek:

<http://www.unhcr.org/refworld/category/REFERENCE,,,GBR,3ae6b0ea8,0.html>

⁵⁰ Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, e disponueshme tek: <http://www.icc-cpi.int/Menus/ICC/Legal+Texts+and+Tools/Official+Journal/Rome+Statute.htm>

⁵¹ Shiko <http://www.icty.org/ENGLISH/basicdocs/statute.html> tek neni 20(4).

⁵² Shiko http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept08_en.pdf tek neni 21(4).

avokat, shteti duhet të paguaj për një avokat të pavarur. Një avokat I till mund të përzgjidhet nga grupi I vullnetarëve të shoqatës locale e avokatëve (ose ekuivalente). Parimi 6 i Parimeve Bazë mbi Rolin e Avokatëve është parashikon se:

Cdo person që nuk ka një avokat, duhet që në cdo rast që e kërkon interesi për drejtësi, të ketë të drejtën për tu asistuar nga një avokat me eksperiencë dhe kompetentë për natyrën e akuzës së ngritur në mënyrë që të sigurojë asistencë ligjore efektive, pa pagesë në rast se personi nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për këtë lloj shërbimi.

Edhe Rregullat Minimale të Kombeve të Bashkuara mbi Standartet e Trajtitimit të të Burgosurve⁵³ trajtojnë këtë çështje. Rregulli N°93 parashikon se:

Me qëllim për të siguruar mbrojtjen e tij, një I burgosur I pagjykuar duhet të lejohet të kërkojë ndihmë ligjore falas kur kjo është e disponueshme dhe të takohet me këshilluesin e tij ligjor me qëllim sigurimin e mbrojtjes së tij dhe përgatitjen e marrjen e instruksioneve konfidenciale. Për këtë qëllim, në qoftë se ai dëshiron, duhet ti sigurohen materiale shkrimi. Intervistat mes të burgosurit dhe këshilltarit të tij ligjor mund ti nënshtrohen mbikqyrjes vizive nga policia apo nga nënpunsit e institucionit por jo të dëgjohen prej tyre.

Rregulli 95 e shtrinë të njëjtën mbrojtje tek të arrestuarit apo të burgosurit pa akuzë.

Parimi 17 i Grupit të Parimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtjen e të gjithë Personave të Ndaluar apo të Burgosur,⁵⁴ parashikon se:

1. Një person i ndaluar duhet të ketë të drejtën të asistohet nga një këshilltar ligjor. Ai duhet të informohet mbi të drejtën e tij nga autoriteti kompetent menjëherë sapo të arrestohet dhe duhet ti sigurohen të gjitha kushtet për ushtrimin e kësaj të drejte.
2. Në qoftë se një person i arrestuar nuk ka një këshilltar ligjor të zgjedhur vet, në të gjitha rastet kur e kërkon interesi për drejtësi, ai duhet të ketë të drejtën të asistohet nga një këshilltar ligjor i caktuar nga një autoritet gjyqsor apo i një lloji tjetër i cili duhet të caktohet pa pagesë në qoftë se personi i arrestuar nuk ka mjete të mjaftueshme monetare për ta paguar.

Si përmbledhje, aksesit sipas këtij konteksti nënkupton konsultimin privat me qëllim për të siguruar ndjekjen e përpiktë të procedurave dhe respektimin e të drejtave të të arrestuarit. Autoritetet janë të detyruara të lehtësojnë konsultimi në atë masë sa është e nevojshme për ta bërë atë kuptimplot.

IV. A është kjo një e drejtë absolute apo e kualifikuar?

Ky seksion mundohet të eksplorojë nëse ekzistojnë kufizime të justifikueshme mbi të drejtën për të pasur akses tek një avokat. A mund të kufizohet kjo e drejtë për shëmbull në rastet e sigurisë kombëtare? A përbënë diferencë fakti nëse I ndaluari do të merret në pyetje formalisht apo thjeshtë do të pyetet joformalisht?

⁵³ Shiko <http://www2.ohchr.org/english/law/pdf/treatmentprisoners.pdf>. Rregullat janë miratuar në Kongresin e Parë të Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve, të mbajtur në Gjenevë në vitin 1955 dhe janë aprovuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social me rezolutën e tij 663 C (XXIV) të datës 31 Korrik 1957 dhe 2076 (LXII) të datës 13 Maj 1977. Ju lutem kini parasysh se pavarësisht emrit të tyre, këto rregulla zbatohen jo vetëm për të burgosurit por gjithashtu për të gjithë personat e arrestuar dhe të ndaluarit e pagjykuar (rule 95).

⁵⁴ Shiko: <http://www2.ohchr.org/english/law/bodyprinciples.htm>

Disa regjime ligjore kombëtare parashikojnë ndalimin

Many domestic legal regimes make provision for incommunicado detention, for example where an ongoing investigation may be jeopardised or where public safety is at risk. However, such regimes increase the risk of ill-treatment and other rights violations, and for this reason should be avoided, or at least strictly circumscribed.

Një nga ekspresionet ndërkombëtare më të hershme mbi mbrojtjen e përfaqësimit ligjor gjëndet në Grupin e Parimeve. Parimi 18 (në paragrafin 3) parashikon se:

3. E drejta e një personi të arrestuar apo të burgosur për tu vizituar apo për tu konsultuar dhe komunikuar me këshilltarin e tij ligjor, pa vonesë apo censurë dhe në konfidencialitet, nuk mund të pezullohet ose të kufizohet përveç se në raste përjashtimore të përcaktuara nga ligji apo rregullat ligjore dhe kur konsiderohet e domosdoshme nga një autoritet gjyqësor apo I një lloji tjetër, për të ruajtur sigurinë dhe rendin.

Megjithatë, kushti më sipër, kufizohet nga parimi 15 i përcaktuar në Seksionin II të këtij materiali.

Grupi I Parimeve u riafirmuar në Dhjetor të 2009 në paragrafet 19-20 të Rezolutës 64/153 të Asamblesë së Përgjithshme.⁵⁵ Në këtë rezolutë, Asambleja:

Risjell rezolutën e saj 43/173 të datës 9 Dhjetor 1988 mbi Grupin e Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të Arrestuar apo të Burgosur, dhe në këtë kontekst thekson se duhet të garantohet që cdo individ i arrestuar apo i ndaluar të paraqitet menjëherë përpara një gjykatësi apo një oficeri tjetër të pavarur gjyqësor, ti lejohet kujdes mjekësor i menjëhershëm dhe i rregullt dhe këshillim ligjor si dhe vizita nga anëtarët e familjes dhe mekanizmat e pavarur monitorues, si masa efektive për parandalimin e torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues.

I rikujton të gjithë Shteteve se arrestimi I tejkzgjatur dhe jokomunikues ose arresti në vënde sekrete mund të lehtësojë kryerjen e torturës dhe cdo trajtimi apo ndëshkimi tjetër mizor, johuman apo degradues dhe mund të përbëjë në vetvete një formë torture, dhe I nxit të gjitha Shtetet të respektojnë masat mbrojtëse që kanë të bëjnë me lirinë, sigurinë dhe dinjitetin e personave dhe të sigurojnë që vendet sekrete të arrestit dhe marrjes në pyetje të mos përdoren më;

Kjo rezolutë, e cila u miratua me konsensus, tregon se komuniteti ndërkombëtar ka konkluduar që arrestimet e tejkzgjatura dhe jokomunikuese dhe arrestimet sekrete nuk duhet të kryen madje edhe në kushte përjashtimore.⁵⁶

ECTHR, në çështjen *Öcalan v Turkey*,⁵⁷ deklaroi se një person duhet të gëzojë të drejtën e aksesit tek një këshilltar ligjor për të sfiduar arrestimin e tij dhe që neni 6 I Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut – e cila përmban garanci për një gjykim të drejtë- normalisht do të kërkojë që i akuzuari të lejohet të përfitojë nga asistenca e

⁵⁵ Shiko: <http://www.un.org/ga/64/resolutions.shtml>

⁵⁶ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (e cila nuk ka hyrë akoma në fuqi por është miratuar me consensus nga UNGA më 20/12/2006) gjithashtu ndalon arrestin sekret, në nenin 17(1).

⁵⁷ Zbatim I 46221/99. Shiko gjithashtu *Murray v UK* (Zbatim I 41/1994).

një avokati që nga faza fillestare e marrjes në pyetje nga policia.⁵⁸ “Megjithatë”, ECtHR vijoi duke thënë se, “kjo e drejtë, e cila nuk është e parashikuar shprehimisht në Konventë, mund të kufizohet për një shkak të mirë. Pyetja që ngrihet në cdo rast, është nëse kufizimi ka privuar të akuzuarin nga e drejta e tij për një gjykim të drejtë apo jo”.⁵⁹

ECtHR riafirmoi dhe përpunoi qëndrimin e saj në *Öcalan* në çështjen *Salduz v Turkey*.⁶⁰ të vitit 2008. Gjykata konstatoi se e drejta për një gjykim të drejtë kërkon akses tek një avokat që nga momenti i marrjes së parë në pyetje, dhe vijoi duke thënë se, edhe kur ka arsye detyruese për ta kufizuar këtë akses, “të drejtat e palës mbrojtëse do të jenë parimisht të paragjykuara në mënyrë të pakthyeshme kur deklaratat inkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje nga policia pa prezencën e një avokati përdoren për të krijuar një bindje” Kjo do të thotë se as heqja dorë nga e drejta për të patur këshilltar ligjor ose përjashtimet e tjera të vlefshme sipas ligjit vëndas nuk do ti justifikojnë domosdoshmërisht autoritetet nga detyrimi për të siguruar akses tek një avokat, në qoftëse referimi tek prova orale përkatëse do të ishte i padrejtë duke marrë parasysh të gjitha kushtet.⁶¹

Për sa i përket kushteve përjashtimore në të cilat e drejta e aksesit tek një avokat mund të kufizohet, duhet të theksohet se Komiteti mbi të Drejtat e Njeriut ka thënë se:

Mbrojtja e të drejtave të njohura shprehimisht si të pa-tjetërsueshme sipas nenit 4, paragrafi 2, duhet të sigurohet nga garanci procedurale, përfshirë këtu zakonisht garancitë gjyqësore. Dispozitat e Marrëveshjes në lidhje me mbrojtjet procedurale nuk mund të jenë subjekt i masave që mund të shmangin mbrojtjen e të drejtave të pa-tjetërsueshme...⁶²

Në vijim të këtij arsytimi, masat mbrojtëse si ajo e drejta për të patur akses tek një avokat nuk duhet të kufizohet kurrë në atë masë sa të lehtësojë shkeljen e nenit 7 të ICCPR (I cili është I pa-tjetërsueshëm).

Reporterit Special mbi Torturën ka trajtuar gjithashtu çështjen e kufizimeve në të mirë të sigurisë dhe ka propozuar një zgjidhje për të paktën një shqetësim të përsëritur të Shteteve:

Në raste përjashtimore, në të cilat ka rrezik që kontakti i menjëhershëm i të arrestuarit me avokatin e tij të shkaktojë shqetësime për sa i përket sigurisë dhe një kufizim i till është miratuar nga një autoritet gjyqësor, duhet të paktën të lejohet një takim me një avokat të pavarur si për shëmbull të rekomanduar nga shoqata e avokatëve...⁶³

Klecka e zakonshme në këtë rast është se aksesit tek një avokat është një mënyrë e rëndësishme për të siguruar që të respektohen të drejtat e tjera të të arrestuarit, përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe për tu mbrojtur nga cdo formë

⁵⁸ *Öcalan v Turkey*, si më sipër, vendimi I Seksionit (Dhomë) të Parë të ECtHR, 12 Mars 2003, tek § 140. Ky pasazh është aprovuar nga Dhoma e Madhe në apel, tek § 131 vendimi i Dhomës së Madhe i datës 12 Maj 2005

⁵⁹ Si më sipër

⁶⁰ Shiko më sipër, N°23

⁶¹ Shiko gjithashtu *Pishchalnikov v Russia* (Zbatim I 7025/04, vendim i Dhomës datë 24 Shtator 2009, në vecanti §§ 72-91), *Oleg Kolesnik v Ukraine* (Zbatim i 17551/02, vendim i Dhomës datë 19 Nëntor 2009 § 35), dhe *Savaş v Turkey* Zbatim i 9672/03 datë 13 Mars 2006; vendim i Dhomës datë 8 Dhjetor 2009, në vecanti §§ 53-70).

⁶² Shiko Komentin e Përgjithshëm 29 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut § 15. Pjesa e mbetur e paragrafit jep një shëmbull ilustrues në lidhje me të drejtën e jetës (neni 6).

⁶³ 2003 Raport drejtuar Komisionit të të Drejtave të Njeriut – shiko më sipër N°5.

keqtrajtimi. Atje ku aksesi tek një avokat mohohet apo vonohet pa të drejtë, rreziku i shkeljes së të drejtave të të arrestuarit është më i madh.

V. Cilat ligje kombëtare parashikojnë këtë të drejtë?

Europa

E drejta e aksesit tek një avokat është e mirë-vendosur në Europë. Rregullat Europiane mbi Burgjet parashikojnë se “personat e pagjykuara duhet të informohen shprehimisht mbi të drejtën e tyre për të patur konsulencë ligjore”.⁶⁴

Një shëmbull i dukshëm i njohjes së kësaj të drejte në Europë është neni 63(4) I Kodit të Procedurës Penale Franceze i cili parashikon se, që nga momenti kur një person është ndaluar, ai mund të kërkojë të flaes me një avokat.⁶⁵ Kjo dispozitë, duke marrë parasysh jurisprudencën e ECTHR si më sipër (vecanërisht çështja *Salduz*), është vënë në praktikë në Korrik dhe Nëntor 2009, kur Gjyqtarët e Instancës së Lartë të Bobinny (Paris-St-Denis) refuzuan të autoizonin vazhdimin e arrestit të personave të dyshuar për një krim serioz, të cilët nuk kishin kontaktuar me një avokat.⁶⁶

Sipas seksionit 10 të kapitullit 23 të Kodit të Procedurës Gjyqësore në Suedi, çdo person i arrestuar ka të drejtën të ketë një avokat prezent kur benë një deklaratë në polici, madje dhe gjatë një hetimi paraprak, për sa kohë që një gjë e till nuk dëmton hetimin.⁶⁷ SPT lavsdëroi këtë dispozitë pas misionit të saj në Suedi në 2008:

SPT mirëpret këtë dispozitë pasi ajo tani lejon prezencën e avokatit që nga momenti i parë i heqjes së lirisë dhe për të gjithë personat të detyruar të qëndrojnë nën mbikqyrjen e policisë. Ajo gjithashtu reflekton faktin se personat që japin deklaratat policisë mund të mos jenë të dyshuar në momentin e parë por mund të bëhen të till më vonë. SPT rekomand që autoritetet Suedeze të ndërmarrin hapat e nevojshme për të siguruar që kjo dispozitë e re të aplikohet në mënyrë efektive në praktikë dhe që personat e detyruar që të qëndrojnë nën mbikqyrjen e policisë, të informohen sistematikisht mbi të drejtat e tyre.⁶⁸

Neni 53, paragrafi 2 I Kodit Grek I Ndëshkimeve garanton aksesit tek një avokat për të gjithë personat që mbahen në burg.⁶⁹ Neni 96 I Kodit të Procedurës Penale gjithashtu garanton të drejtën e komunikimit ndërmjet personave të akuzuar për një krim dhe

⁶⁴ Shiko Rekomandimin Rec(2006)2 e Komitetit të Ministrave, të disponueshme tek:

<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=955747>.

⁶⁵ Përkthim jo zyrtar – në origjinal është: *Dès le début de la garde à vue, la personne peut demander à s'entretenir avec un avocat*.

⁶⁶ Vendimet e Gjykatës nuk janë të publikuara, por një kopje e vendimit të datës 30 Nëntor 2009 është e disponueshme në faqen e internetit të LeMonde.fr:

<http://combatsdroitshomme.blog.lemonde.fr/files/2009/12/decision-jld-bobigny-cedh.1259856473.pdf>. See further

<http://www.abolir-gardeavue.fr> – faqe interneti e fushates së avokatëve francezë për të reformuar sistemin e “garde à vue” me qëllim që të përfshihet afati kohor I aksesit tek avokati. Ju lutem kini parasysh se ky zhvillim ligjor nuk është pa polemika - *Le Syndicat des Commissaires de la Police Nationale* (Sindikata e Komisarëve të Policisë Kombëtare) (www.le-scpn.fr) mbajtën një komunikatë për shtyp në datën 3 Dhjetor 2009 ku kërkonte prioritetin e të Drejtave Europiane të Njeriut mbi Ligjin Francez vëndas.

⁶⁷ Një përkthim (zyrtar) në Anglisht I Kodit është I disponueshëm tek:

<http://www.regeringen.se/content/1/c4/15/40/472970fc.pdf>

⁶⁸ Shiko *Raportin mbi vizitën e UNSPT në Suedi*, (CAT/OP/SWE/1, 10 Shtator 2008), tek § 56.

⁶⁹ Në mungesë të një përkthimi të gatshëm të kodit, shiko komunikatën e Shefit të Policisë Fotios Nasiakos të datës 04/07/2003 mbi trajtimin dhe të drejtat e personave të arrestuar nga Policia Greke, e disponueshme tek: <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/426fa1f14.pdf>, at § 3(f).

avokatëve të tyre.⁷⁰ Në vitin 2003, Shefi i Policisë Greke nxorri një Protokoll (Direktivë) në të cilën deklaronte se të gjithë policat grek duhet të veprojnë në përputhje me nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të lejojnë aksesin e lirë tek avokati të të gjithë të arrestuarve (si për arsye kriminale ashtu dhe administrative).⁷¹

Në Mbretërinë e Bashkuar, sipas *Aktit të të Dhënave Kriminale dhe të Policisë* (PACE Act),⁷² të vitit 1984, ka kode praktikash, përfshirë Codin C, i cili parashikon kërkesat për arrestimin, trajtimin dhe marrjen në pyetje të personave të dyshuar, që nuk kanë lidhje me terrorizmin dhe që gjenden nën mbikëqyrjen e oficerëve të policisë.⁷³ Kodi parashikon se “e drejta për tu konsultuar privatisht me një avokat dhe për të patur asistencë ligjore të pavarur dhe pa pagesë, duhet të mundësohet në cdo fazë gjatë periudhës së arrestit”.⁷⁴ Shënimi 1A në Kod, specifikon se personat të cilët gjenden vullnetarisht në një rajon policie (për shembull si dëshmitarë) duhet gjithashtu tju akordohet e drejta absolute e për të patur asistencë ligjore.⁷⁵ Megjithatë, sipas 67(10) të Aktit PACE,⁷⁶ nuk lind asnjë përgjegjësi civile ose penal nga një shkelje e Kodit.

Neni 255(1) dhe 256 i Kodit Shqipëtar të Procedurës Penale parashikon se:

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrest ose ndalim ose e kanë kapur të arrestuarin në flagrancë, duhet të njoftojnë menjëherë prokurorin për vendin ku është kryer arresti ose ndalimi. Ata duhet ti shpjegojnë të arrestuarit apo të ndaluarit se ai nuk është i detyruar të bëjë deklaratat dhe se ka të drejtë të zgjedhi një avokat dhe duhet të njoftojnë menjëherë avokatin e përzgjedhur ose të caktuar nga prokurori.

Prokurori merr në pyetje të arrestuarin apo të ndaluarin në prezencë të avokatit të zgjedhur prej tij apo të caktuar. Ai duhet ti njoftojë të arrestuarit apo të ndaluarit faktin për të cilin ai po procesohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i bërë të njohur informacionet që kanë lidhje me akuzat kundër tij dhe kur hetimi nuk dëmtohet, duhet ti bëjë të njohur edhe burimet e këtyre informacioneve.⁷⁷

Kodi i Procedurës Penale i Federatës Ruse përmban garancitë e mëposhtme:

“I dyshuari duhet të ketë të drejtën të përfitojë nga këshillat e një avokati për mbrojtjen e tij, që nga momenti i caktuar në pikat 2 dhe 3 të pjesës së tretë të Nenit 49 të këtij Kodi, si dhe të ketë vizita private dhe konfidenciale me avokatin e tij përpara marrjes së parë në pyetje...”⁷⁸

Shumë Kode Penale Europiane dhe Kushtetuta përmbajnë garanci të kësaj natyre.⁷⁹

⁷⁰ Si më sipër tek § 3(e).

⁷¹ Si më sipër.

⁷² E disponueshme tek: http://www.opsi.gov.uk/acts/acts1984/pdf/ukpga_19840060_en.pdf

⁷³ <http://police.homeoffice.gov.uk/operational-policing/powers-pace-codes/pace-code-intro/>

⁷⁴ Si më sipër, tek faqja 9.

⁷⁵ Si më sipër, tek faqja 5.

⁷⁶ Shiko më sipër, N°73.

⁷⁷ Shiko:

<http://www.legislationline.org/download/action/download/id/1654/file/3e7ef0be7ad60ee6e16cbd8b63db.htm/preview> (Përkthim Anglisht)

⁷⁸ E disponueshme tek:

<http://www.legislationline.org/download/action/download/id/1698/file/3a4a5e98a67c25d4fe5eb5170513.htm/preview> - shiko gjithashtu nenet 49(3)(3) dhe 92(4)

⁷⁹ Përkthime jo zyrtare të këtyre ligjeve, janë të disponueshme tek:

<http://www.legislationline.org/documents/section/criminal-codes>. Kode e tjera që përmbajnë mbrojtje të kësaj natyre, janë: Kodi i Procedurës Penale I Republikës së Azerbaxhanit (neni 85.2.3); Kodi i Procedurës Penale i

Shtetet Amerikane

Amendamenti i gjashtë dhe i katërmbëdhjetë i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara⁸⁰ garanton të drejtën e aksesit tek një avokat në momentin kur ose pas fillimit të procedimit gjyqësor kundër një personi. Gjykata e Lartë e ka interpretuar se në këtë kontekst përfshihet arresti me mandat dhe marrja në pyetje.⁸¹

Kanadaja parashikon të drejtën për avokat në Kartën e saj të të Drejtave dhe Lirive.⁸² Gjykata e Lartë e Kanadasë, në çështjen *Suberu v The Queen*⁸³ të vitit 2009, konsideroi nëse e drejta për avokat do të mund të trajtohej ndryshe në rastet e arrestit pa akuzë dhe konkludoi se kjo e drejtë lind që në momentin kur një person arrestohet dhe mund të kufizohet vetëm kur çënohet siguria personale ose parashikohet nga ligji dhe gjithmonë në përputhje me qëllimet e Kartës.⁸⁴

Kushtetuta e Meksikës e vitit 1917, e ndryshuar, parashikon se një person ka të drejtë të mbrohet nga një avokat dhe mund ta zgjedhë këtë avokat në cdo kohë që nga momenti i arrestit/ndalimit.⁸⁵ E drejta e aksesit parashikohet edhe për më vonë, në të njëjtin paragraph “në të gjitha fazat e procesit/procedimit”.⁸⁶ Ashtu si dhe në Shtetet e Bashkuara, ka polemika nëse e drejta e aksesit lind që nga momenti i heqjes së lirisë apo në një moment të mëvonshëm.⁸⁷

Oqeania

Akti Karta e të Drejtave e Zelandës së Re, e vitit 1990, parashikon se:

Cdo njeri i cili është i arrestuar apo i ndaluar bazuar në çfarëdo lloj ligji... duhet të ketë të gëzojë pa vonesë, të drejtën për tu konsultuar dhe instruktuar nga një avokat dhe duhet të informohet mbi këtë të drejtë...⁸⁸

Në mënyrë të ngjashme, Seksioni 65(c)(ii) i Kushtetutës së Ishujve Cook, parashikon se:

Republikës së Srpska (nenet 47(1) dhe 201(5)); Kodi i Procedurës Penale i Bullgarisë (neni 97); Kodi i Procedurës Penale i Estonisë (neni 45); Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë (neni 3); Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Moldavisë (neni 17); Kodi i Procedurës Penale i Malit të Zi (nent 5 dhe 13); Kodi i Procedurës Penale i Norvegjisë (nent 96-8 dhe 107); Kodi Federal i Procedurës Penale i Zvicrës (neni 35 – ky nen njih të drejtën për avokat vetëm që nga seanca e parë për masën e arrestit, e cila zhvillohet brenda 24 orëve nga arresti fillestar); Kodi i Procedurës Penale i Uzbekistanit (neni 49, i ndryshuar në 1999). Ju lutem kini parasysh se kjo listë nuk është e zauruese – ajo përfshinë vetëm kodet për të cilat autori ka mundur të gjejë përkthimet e përshtatshme.

⁸⁰ Këto parashikojnë: garancitë për sigurimin e asistencës ligjore për tu mbrojtur nga një akuzë penale dhe process të drejtë në rastin e heqjes së lirisë – shiko <http://www.archives.gov/exhibits/charters/constitution.html>.

⁸¹ Shiko *Brewer v Williams* 430 US 387 (1977), i disponueshëm jo zyrtarisht tek: http://www.law.cornell.edu/supct/html/historics/USSC_CR_0430_0387_ZO.html, tek pp.398-9.

⁸² Tek seksioni 10(b) – shiko: <http://laws.justice.gc.ca/en/charter/under> (“Legal Rights”).

⁸³ 2009 SCC 33, teksti i plotë jo zurtar është i disponueshëm tek:

<http://scc.lexum.umontreal.ca/en/2009/2009scc33/2009scc33.html> (përmbledhja zyrtare është e disponueshme tek: <http://www.scc-csc.gc.ca/case-dossier/cms-sgd/sum-som-eng.aspx?cas=31912>).

⁸⁴ Si më sipër – shiko në vecanti § 2 të vendimit të shumicës

⁸⁵ Përkthim jozyrtar – origjinali është: *Tendrá derecho a una defensa adecuada por abogado, al cual elegirá libremente incluso desde el momento de su detención* - neni 20(B), § VIII – shiko:

<http://www.diputados.gob.mx/LeyesBiblio/pdf/1.pdf>.

⁸⁶ Përkthim jozyrtar – origjinali është: “...en todos los actos del proceso”.

⁸⁷ Shiko Raportin Special me titull *I Presumuar Fajtor: Drejtësia Penale dhe të Drejtat e Njeriut në Meksikë* – 24 Fordham Intl LJ (2000-01) 801 tek 843.

⁸⁸ Në seksionin s23(1)(b) – shiko: <http://www.legislation.govt.nz/act/public/1990/0109/latest/DLM224792.html>

Asnjë ligj nuk duhet të hartohet ose aplikohet në mënyrë që të privojë një persona të arrestuar apo të ndaluar, nga e drejta e tij për të patur dhe për të njoftuar një avokat pa vonesë.⁸⁹

Afrika

Në Madagaskar, neni 4 i Ligjit kundër Torturës, i vitit 2008⁹⁰ parashikon aplikimin e disa garancive themelore “duke filluar që nga momenti i heqjes së lirisë”,⁹¹ ku përfshihet e drejta “për një avokat apo për assistencën e një personi të zgjedhur prej personit të arrestuar”.

Seksioni 35(2)(b) i Kushtetutës së Afrikës Jugore parashikon se “Cdo njeri i arrestuar, përfshirë këtu edhe personat e dënuar me burgim, ka të drejtën të zgjedhi dhe të konsultohet me një avokat, dhe të informohet për këtë të drejtë menjëherë”.⁹²

Në po këtë linjë, seksioni 14(2) I Kushtetutës së Republikës së Ganës parashikon se: “Një person i arrestuar, i ndaluar apo i kufizuar duhet të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestit, ndalimit apo kufizimit dhe për të drejtën për të patur një avokat të zgjedhur vet.”

Të tjerët

Në legjislationet kombëtare ka një numër të madh garancish të kësaj natyre, por përfshirja e tyre në këtë material do shkonte përtej qëllimit të tij. Megjithatë shëmbujt e mësipërm tregojnë se e drejta e aksesit tek një avokat, në rastet e heqjes së lirisë, është gjërisht e njohur - edhe në qoftë se vënde të ndryshme zgjedhin ta karakterizojnë atë në mënyra të ndryshme.

Arritjet e rekomanduara

Një problem i hasur në shumë prej vëndeve të përmendura më sipër është se e drejta e aksesit tek një avokat lidhet me procedurat penale dhe kufizohet tek të dyshuarit. Megjithatë, për të krijuar një mbrojtje gjithëpërfshirëse kundër torturës, keqtrajtimit dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, aksesit tek një avokat duhet të gëzohet nga cdo person të cilit i është hequr liria, përfshirë këtu ata që mbahen në një formë arresti administrative,⁹³ dëshmitarët dhe personat e tjere me interes për autoritetet. Për këtë arsye, arritja ideale është të përfshihet kjo garanci në një Kartë të Drejtash universalisht të zbatueshëm.

⁸⁹ Teksti i Kushtetutës është i disponueshëm tek: http://www.paclii.org/ck/legis/num_act/cotci327. Evitimi i kësaj të drejte përpara marrjes në pyetje coi në një vendim papranueshmërie në çështjen *Police v Ngametua Tutakiau* [2001] Ishujt Cook.

⁹⁰ Zyrtarisht *Loi #2008-008 of 25 June 2008 contre la torture et autres peines out traitements cruels, inhumains ou dégradants* – e disponueshme tek: <http://www.apt.ch/tld/Madagascar.pdf>

⁹¹ Në original: “...dès l’instant où intervient la privation de liberté d’une personne...”.

⁹² <http://www.info.gov.za/documents/constitution/1996/a108-96.pdf>

⁹³ Mbështetje për këtë propozim mund të gjendet në Grupin e Parimeve (Shiko më sipër, N°54. Përkufizimi I termit “i arrestuar” nuk është i limituar vetëm për çështjet penale, dhe në Rezolutën 1993/36 për sa i përket çështjes së arrestit arbitrar, Komisioni i mëparshëm i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut deklaroi specififikisht se Grupi I Parimeve mbulon arrestin administrative [Shiko:

<http://www.unhchr.ch/Huridocda/Huridoca.nsf/TestFrame/fe59d64a20ec7117c1256a8400459c75?Opendocument> tek PP6]). Rregullat Standarte Minimale (shiko më sipër, N°53) shtrihen gjithashtu tek personat e arrestuar apo ndaluar pa akuzë (shiko rregullin 95), dhe Standartet e CPT I referohen aksesit tek një avokat për migrantët e parregullt të arrestuar në mënyrë administrative [Rev 2009, tek faqja 50 – shiko më sipër, N°38].

VI. Të Drejtat e Lidhura

Përvec nenit 7 të ICCPR dhe nenit 2 dhe 16 të UNCAT (dhe mbrojtjeve të tjera të mirë vendosura, kundër torturës dhe keqtrajtimit⁹⁴), aksesit tek një avokat lidhet me ndalimin ndërkombëtar të arrestit arbitrar, të parashikuar në nenin 9(1) të ICCPR.⁹⁵ Neni 9(3) dhe 9(4) lidhen me sa më sipër. E drejta për tu paraqitur menjëherë përpara një gjykate për një ceancë paraprake dëgjimore⁹⁶ dhe e drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestit (Habeas Corpus), janë masa të tjera mbrojtëse kundër torturës dhe keqtrajtimit. Në rezolutën nr. 34/178, Asambleja e Përgjithshme e Kombëve të Bashkuara:

Konsideron se përdorimi i këtyre masave mund të parandalojë mundësinë që personat me pushtet mbi të arrestuarit, të përfshihen në torturë ose trajtime apo ndëshkime mizore, jo humane ose degraduese...⁹⁷

Megjithëse parashikohen nga ligji ndërkombëtar, repsektimi I këtyre të drejtave nuk është universal dhe kjo situataë nuk do të përmirësohet deri sa të arrestuarit të kenë akses tek përfaqësimi ligjor kompetent.

Për më tepër, sic është përmendur dhe më parë, ka një kapërcim ndërmjet kësaj të drejte dhe të drejtës për një përfaqësim të përshtatshëm ligjor në gjyqet penale.⁹⁸ Megjithëse ky material fokusohet mbi të drejtën e aksesit tek një avokat më shumë si një masë mbrojtëse kundër keqtrajtimit se sa si garanci për një gjykim të drejtë, është e qartë se dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje pa prezencën e avokatit mund të rezultojë në krijimin e një bindjeje të padrejtë.⁹⁹

⁹⁴ Shiko për shembull nenin 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (e disponueshme tek: <http://www.echr.coe.int/NR/rdonlyres/D5CC24A7-DC13-4318-B457-5C9014916D7A/0/EnglishAnglais.pdf>), nenin 5 të Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut (e disponueshme tek: <http://www.cidh.org/Basicos/English/Basic3.American%20Convention.htm>), ose nenin 5 të Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut (e disponueshme tek: <http://www.africa-union.org/root/au/Documents/Treaties/Text/Banjul%20Charter.pdf>).

⁹⁵ Shiko për shembull nenin 9 të Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike; nenin 5 të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, nenin 7 të Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, ose nenin 6 të Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut.

⁹⁶ Në Komentin e Përgjithshëm N°8, HRC deklaroi se: "Paragrafi 3 I nenit 9 kërkon se në çështjet penale çdo person i arrestuar ose i ndaluar duhet të paraqitet menjëherë përpara një gjykatësi ose oficeri tjetër të autorizuar nga ligji për të ushtruar autoritet gjyqësor. Në shumicën e Shteteve janë caktuar me ligj limite kohore më precise dhe sipas pikëpamjes së Komitetit, vonesat nuk duhet të jenë më shumë se disa ditë."

⁹⁷ Shiko: <http://www.un.org/documents/ga/res/34/a34res178.pdf> tek §2. "këtyre masave" i referohet *amparo*, *habeas corpus* ose masave të tjera me të njëjtin efekt (shiko § 1).

⁹⁸ Shiko për shembull nenin 14 të Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike; nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 8 të Konventës Amerikane të të Drejtave të Njeriut, ose nenin 7 të Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut.

⁹⁹ Shiko për shembull çështjen *Salduz v Turkey*, më sipër n 23 – në vecanti § 55 të vendimit të Dhomës së Madhe të datës 27 Nëntor 2008.

Konkluzione

E drejta e aksesit tek një avokat, e mbështetur nga bashkëpunimi me autoritetet arrestuese, është jetike për zbatimin e përshtatshëm nga ana e Shtetit, të neneve 2 dhe 16 të UNCAT (detyrimi për të parandaluar), si dhe për të ulur rrezikun e shkeljes së të drejtave të njeriut. Në shtetet ku gjyqësori ka kontroll të limituar ndaj arrestimeve, roli i avokatëve të pavarur është edhe më i rëndësishëm.

Për rrjedhojë, rekomandohet fuqishëm që cdo Qeveri e cila nuk e ka pasur legjisllacionin e saj kombëtar me këtë të drejtë, ta bëjë menjëherë duke patur parasysh elementët thelbësorë të kësaj garancie, si më poshtë:

- Duhet të aplikohet që nga momenti i parë i heqjes së lirisë, ose në cdo rastë përpara cdo lloj marrje në pyetje;
- duhet të aplikohet ndaj cdo të arrestuari kudër dëshirës së tij dhe jo vetëm ndaj atyre të dyshuar për krim;
- takimi i avokatit me të arrestuarin nuk duhet të jetë i kufizuar dhe privat, dhe
- duhet të bëhen parashikime në legjisllacionin përkatës për:
 - masat disiplinore ndaj autoriteteve të cilët refuzojnë të lejojnë aksesin tek avokati, dhe
 - mos pranimin e cdo prove të siguruar duke mos respektuar këtë garanci.

Parashikimi i prezencës së avokatit gjatë cdo lloj marrjeje në pyetje, kudo që është e mundur, do të rriste akoma më shumë mbrojtjen dhe do të ulte rrezikun e shkeljeve.

Të drejtat ekzistuese të aksesit tek avokati të parashikuara në legjisllacionet kombëtare, të cilave u mungojnë këto elementë thelbësorë, duhet të rishikohen.



Association for the Prevention of Torture - APT
Route de Ferney 10 P.O. Box 137 CH-1211 Geneva 19
Tel : (+41 22) 919 2170 Fax: (+41 22) 919 2180
e-mail: apt@apt.ch Internet: www.apt.ch